

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	A mund të ndryshohet ligji për Specialen dhe të falen të dënuarit? Përgjigjet ish-eprori i UÇK-së
ADRESA	https://albeu.com/kosove/a-mund-te-ndryshohet-ligji-per-specialen-dhe-te-falen-te-denuar-it-pergjigjet-ish-eprori-i-uck-se/1031659/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 19:28:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 19:24:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	051833bb8a5be79bcaba0f13229023b60dbe6328e9670a6246762af40e33737c
TEKSTI	1a9155135a0fd122d323779d340379cf1a9d874009d7fd8021b5d1a690d9c5e7
PAMJA	9334bb7cef8ab4c382889a3fe4ab750d49fd548f141905f76e7bc89f76056e92

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	360b2526611848c76e97fbb87ea5ee9955c14ff19cf8613b65f57a88f2a1881a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1fd94ce259103b5d3a93736e630fca63414b31f94ba022dd5b4f87109ff485e9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/360b2526611848c76e97fbb87ea5ee9955c14ff19cf8613b65f57a88f2a1881a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

A mund të ndryshohet ligji për Specialen dhe të falen të dënuarit? Përgjigjet ish-eprori i UÇK-së



Kuvendi i ri i Kosovës miratoi të hënën një deklaratë për aktgjykimin e shkallës së parë të Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Tekstin, i cili kishte marrë më herët përkrahjen e Lëvizjes Vetëvendosje, Partisë Demokratike të Kosovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës, Aleancës dhe Grupit Parlamentar Multietnik, para deputetëve e lexoi kryeparlamentarja Albulena Haxhiu. Në votim, dokumenti u miratua me 99 vota pro, pa vota kundër dhe pa abstenime.

Paralelisht, në Kuvend është rihapur diskutimi për ndryshimet në ligjin që rregullon Dhomat e Specializuara të Kosovës. PDK-ja e paraqiti nismën javën e kaluar, pas aktgjykimit ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit, të cilët janë dënuar me gjithsej 81 vjet burgim.

Sipas projektligjit të PDK-së, juridiksioni i Dhomave të Specializuara do të kufizohej te veprat penale të përmendura në raportin e vitit 2011 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Raporti trajtonte, ndër të tjera, pretendimet për trafikim organesh pas luftës në Kosovë.

Propozimi parasheh gjithashtu ndryshimin e periudhës që mbulon juridiksioni i Gjykatës: në vend të janarit 1998 – dhjetorit 2000, të përfshihet intervali nga 1 korriku 1999 deri në dhjetor 2000. Një tjetër pikë përcakton se dënimi më i lartë që mund të shqiptohet do të ishte 15 vjet burgim.

PDK-ja kërkon edhe që dënimet e dhëna nga Dhomat e Specializuara të vuhet në Kosovë dhe që të dënuarit të mund të përfitojnë nga falja presidenciale.

Aleanca e ka mbështetur nismën, ndërsa Vetëvendosje ka thënë se para se të marrë qëndrim do ta analizojë projektligjin nga pikëpamja juridike. LDK-ja ende nuk ka njoftuar qëndrimin e saj zyrtar.

Ndryshe nga deklarata për aktgjykimin e Hagës, e cila u miratua me mbështetje të gjerë, ndryshimet e

të fundit /



A mund të ndryshohet ligji për Specialen dhe të falen të dënuarit?...



Roberto Carlos: 11 fëmijë, 7 gra, 3 Liga të Kampionëve dhe një...



Dita e 121 e protestës në Tiranë, qytetarët marshojnë drejt "Qyte...



Esposito shkruajnë historinë e Italisë, përsëritet një rekord...



Qendra "Gjenocidi në Kosovë -- Plagë e hapur" mirëpret...



Haxhiu: Kuvendi duhet të shprehte qëndrimin për aktgjykimin e...



Gjimshiti: San Marino nuk duhet nënvlerësuar, gjithçk...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

propozuara në ligj pritet të nxisin debat të ri politik dhe juridik mes partive.

Naim Miftari, ish-agjent i SHIK-ut dhe ish-epror i UÇK-së, e cilëson deklaratën e Kuvendit si të pavlefshme dhe humbje kohe. Ai thotë se Gjykata nuk mund të shpërbëhet pa një kërkesë zyrtare nga BE-ja dhe SHBA-ja, ndërsa falja e të dënuarve nga presidentja, sipas tij, nuk mund të realizohet as me ligjin aktual.

"Deklarata është vetëm humbje kohe, më shumë ka karakter folklorik dhe sidomos PDK-ja, e cila është fajtori kryesor që kemi këtë gjykatë sot, po tenton ta pastrojë vetveten si Pilati kur i lau duart pasi e kryqëzoi Jezusin e Nazaretit. Gjykata as që zhbëhet sot pa e kërkuar zyrtarisht Bashkimi Evropian dhe SHBA-ja, ndërsa qëllimi që t'i amnistojë presidenten më vonë, as me ligjin ekzistues nuk mund të bëhet dhe nuk kthehet më koha kur Hashim Thaçi kishte fuqinë e një perandori: ishte president, ishte kryeministër, ishte kryetar parlamenti, ishte ministër i Drejtësisë e ishte edhe kryeprokuror... I falte, i lironte kriminelë e dostat e tyre të dënuar për vrasje, ndërsa kur nuk ke pasur armik, je dënuar e ndjekur pa kurrfarë të drejte ligjore e njerëzore", ka deklaruar Miftari për "Bota sot".

Miftari foli edhe për pretendimet se Gjykata Speciale është serbe dhe ruse. Sipas tij, ata që votuan për themelimin e saj do të duhej të shpalleshin tradhtarë nëse këto pretendime do të ishin të vërteta.

"Kosova duhet ta apelojë vendimin e gjykatës, kaq me rëndësi. Ligji për krime kundër njerëzimit është rrëzuar, të tjerat janë më me pak dëme, por me rëndësi është se UÇK-ja nuk ka kryer krime as kundër njerëzimit, as të luftës, por ka individë e grupacione, klane që e kanë shfrytëzuar luftën, e kanë shfrytëzuar edhe uniformën e UÇK-së për t'i arritur qëllimet e tyre kriminale...!

Gjykata Speciale është formuar nga Parlamenti i Kosovës, po dëgjoj sot patriotë me bateria e multimilionerë të korrupsionit e disa profitorë të luftës po thonë se kjo gjykatë me Dhomat e Specializuara në Hagë është gjykatë serbe e gjykatë ruse, por kjo është një rren, pasi po të ishte ashtu, atëherë sot në Kosovë do të duhej së pari të dënoheshin të gjithë 84 deputetët e Kuvendit të Kosovës si tradhtarë, si dorë e zgjatur e Serbisë e Rusisë. Tek tani ke të drejtë ta quash GJSPK-në gjykatë serbo-ruse", ka thënë ish-eprori.

Sipas tij, asnjë luftëtar apo komandant i UÇK-së nuk akuzohet dhe nuk dënohet për shkak se ka luftuar për lirinë e popullit ose ka zhvilluar luftë të pastër.

Miftari kërkon që Kosova të krijojë një komision të pavarur hetimor për të hulumtuar ndikimin e shërbimeve sekrete. Ai pretendon se prokurorët dhe gjyqtarët janë amerikanë, evropianë e zviceranë dhe se askush nuk dënohet pa prova.

"Gjykatësit, të gjithë prokurorët dhe gjyqtarët janë amerikanë, janë evropianë, janë zviceranë... Asnjë njeri, individ, nuk dënohet pa fakte, pa dëshmi. Asnjë luftëtar e komandant i UÇK-së as nuk akuzohet, as nuk dënohet pse ka bërë luftë të pastër dhe ka luftuar për lirinë e popullit tonë.

Kosova, si shtet, duhet ta formojë një komision të pavarur hetues, ta gjurmtojë e studiojë ndikimin e madh të shërbimit sekret të UDB-KOS-it serb dhe shërbimit sekret pro-serb, shërbimin DGSE francez, disa individë kryesorë të UÇK-së politike si vetë Hashim Thaçi duhet të japin shpjegime: ku ishte, kush i solli dhe qëllimin pse i sollën pas luftës në pushtet, pasi pothuajse gjatë luftës, rastësisht apo jo rastësisht, u vranë pothuajse të gjithë komandantët kryesorë të luftës, komandantët e UÇK-së, komandantët e betejave. Pse nuk u vra asnjë komandant i Hotel Rognerit apo pse nuk është vrarë asnjë komandant i Fondit "Vendlindja Thërret", që pas luftës të gjithë u bënë multimilionerë e politikanë...?", ka përfunduar Miftari.

Shitur më 28.09.2026 21:24



Tahiraj kritikon deklaratën për Specialet dhe kërkon shpjegime nga LDK-ja për...



Qendra "Gjenocidi në Kosovë – Plagë e hapur" mirëpret qëndrimin e...



Haxhiu: Kuvendi duhej të shprehte qëndrimin për aktgjykimin e padrejtë



BE shqyrton afate për anëtarësimin e katër vendeve, ndërsa Kosova,...



Mbetjet mortore të dy personave identifikohen, nuk i përkasin "Grupit të...

Fetoshi: Fjalimi i Vuçiqit në OKB synoi t'i bëjë presion Perëndimit

Remi rikthen thirrjen për një bashkëqeverisje mes VV-së dhe PDK-së

Afati për zgjedhjen e Presidentit po skadon, Gjanaj: LVV dhe PDK en...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.